



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-328

Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2017 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet Diakonie Training Center- DTC në Mitrovicë me adresë Rruga Bislam Bajgora p. n, për periudhën 27.09.2017 deri 27.09.2020 me kualifikimin:

1.1. Paruker/Parukiere, Niveli III sipas KKK me 40 kredi të AAP.

2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për kualifikimin:

Parukier/Parukiere

2.1. Adaptimi i planprogramit në aspektin e përmbajtjes dhe në veçanti sasia e orëve për secilin modul.

2.2. Të trajnohet dhe certifikohet stafi mësimor në aspektin pedagogjik.

2.3. Të bëhen trajnime shtesë të stafit trajnues në aspektin teorik të parukerisë e në veçanti për modulet: Puna në recepcion; Shëndeti dhe siguria në punë.

2.4. Të organizohet monitorimi i jashtëm i vlerësimit të kandidatëve.

2.5. Të zhvillohen mekanizma të sigurimit të brendshëm të cilësisë (si p.sh. pyetësorë anonimë për nxënësit rreth vlerësimit të stafit, masat rreth identifikimit dhe përmirësimit të rezultateve nga anketat).

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datën 30.12.2017 sipas raportit të jashtëm vlerësues për kualifikim. Në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi u dërgohet:
 - Diakonie Training Center- DTC;
 - AKK.



Bedri Xhafa

Kryetari i KD së AKK-së